**VENDIM**
**Nr.14, datë 23.4.2020**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRDITËSUAR TË STRUKTURAVE AKOMODUESE PËR AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", dhe të vendimit nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19", Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot më 23.4.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së përditësuar të strukturave akomoduese, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19.
2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**LISTA E PËRDITËSUAR E STRUKTUARVE AKOMODUESE TË EVIDENTUARA NGA UTSH DHE ATA DHE TË DAKORDËSUAR NGA MTM**

| Nr. | Emri hotelit | Vendndodhja Hotelit |
|---|---|---|
| 1 | Hotel "AS" | Golem |
| 2 | Hotel "Ibiza" | Golem |
| 3 | Hotel "Bonita" | Golem |
| 4 | Hotel "Sun" | Durrës |
| 5 | Hotel "Gloria" | Golem |
| 6 | Hotel "Horizont" | Durrës |
| 7 | Hotel "Brilliant" | Golem |
| 8 | Hotel "Kolaveri" | Mali i Robit |
| 9 | Hotel "Fafa" | Golem |
| 10 | Hotel "Eter" | Mali i Robit |
| 11 | Hotel "Dolce Vita" | Golem |
| 12 | Hotel "Brothers Dijon" | Golem |
| 13 | Hotel "Alvin" | Golem |
| 14 | Hotel "Belmondo" | Golem |
| 15 | Hotel "Bleart" | Golem |
| 16 | Hotel "Casa" | Golem |
| 17 | Hotel "Rafaelo | Lezhe |